



Dr. Abaz Aliko

Lektor

**Fakulteti i Biznesit dhe Drejtësisë
Tirana Business University College**

Dr. Abaz Aliko është diplomuar si ekonomist plani në Institutin e Lartë Bujqësor të Tiranës. Ai ka fituar gradën “Master” në ekonomi dhe politikë agrare nga Universiteti Bujqësor i Tiranës dhe gradën shkencore “Doktor i Shkencave” në ekonomi dhe politikë agrare po nga Universiteti Bujqësor i Tiranës. Dr. Aliko ka një eksperiencë mbi 20 vjeçare si lektor në lëndët e financës në disa universitete të vendit, publike dhe private.

Krahas përvojës universitare ai ka një përvojë të pasur në administratën publike dhe në biznesin privat. Ai është këshilltar i jashtëm i Bordit të Entit Rregullator të Energjisë për tarifatat dhe çmimet e rregulluara të energjisë elektrike dhe gazit natyror (2020 –), ka qenë anëtar i Bordit të Entit Rregullator të Energjisë, i caktuar nga Kuvendi për dy mandate (2008-2018), Zv. Drejtor i Përgjithshëm i Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe Drejtor i Njësisë së Tatimpaguesve të Mëdhenj (2007-2008), agjent dhe zyrtar doganor (1994-2000). Dr. Aliko ka qenë dhe është aktiv në tregun e konsulencës private, si në rrafshin rajonal (Gjirokastër: 2000-2005) ashtu dhe në atë kombëtar (2018 –), ku ka marrë pjesë dhe ka kontribuar në shumë projekte e studime, kryesisht në fushën e energjisë, por edhe më gjerë. Ai ka publikuar artikuj shencorë brenda dhe jashtë vendit. Dr. Aliko është anëtar i IENE (Institute of Energy for South East Europe – Greece), ku kontribuon veç të tjerash në profilin e energjisë për Shqipërisë në botimin periodik: “South East Europe Energy Outlook”.